



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS V...

Numri i lëndës: 2023:142595

Datë: 08.08.2024

Numri i dokumentit: 06031671

P.nr.195/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me bashkëpunëtorin profesional Besart Prishtina, në çështjen penale kundër të pandehurit K.H me adresë në Vushtri, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.721/22,të datës 23.06.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljes së aktgjykimit me datën 10.07.2024, më datë 08.08.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

K.H nga i ati H..., e ëma F..., e vajzërisë B..., i lindur më data e lindjes ..., në Vushtri ku edhe jeton, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion instalues i ngrohjes qendrore, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 24.03.2022, rreth orës 18:31, në Vushtri saktësisht në stadiumin e gomës, afër parkut të qytetit, i pandehuri, pa autorizim, posedon substancë narkotike ashtu që zyrtarët policor me rroba civile kishin shkuar në stadiumin e qytetit dhe posa i janë afruar të pandehurit, i njëjti kishte bërë lëvizje të çrregulluara, afër tij ishte gjetur një qese me substancë të dyshuar narkotike dhe pas kontrollit tek i pandehuri kishin gjetur disa pika të syve, një cigare të dëmtuar Winston, të njëjtat janë konfiskuar nga ana e zyrtarëve policor, pas ekzaminimit të të njëjtave në laborator të forenzikës është konstatuar se dëshmia #1 është substancë narkotike e llojit marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë të përgjithshme neto 0.37gram.

- Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39,40, 43, 69, 70, dhe nenit 269 paragrafi 2 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449 të KPPK-së, të pandehurin e:

## G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej tetëqind (800.00) Euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtu që njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm nga Policia e Kosovës i substancës narkotike e llojit marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë të përgjithshme 0.37gram, në mbështetje të nenit 269 paragrafi 3 i KPRK-së.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej njëqind (100) Euro dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën njëzet (20) Euro. Të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP-II.nr.721/22,të datës 23.06.2023, kundër të pandehurit K.H me adresë në Vushtrri për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën i pandehuri është deklaruar i pafajshëm. Gjykata pas kësaj ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe atë me datën 30.05.2024 në të cilën i pandehuri është deklaruar i pafajshëm dhe pastaj në 10.07.2024 janë dhënë fjalët përfundimtare të palëve.

### *Pretendimet e palëve*

Prokurori i Shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë është do të vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe atë bazuar në provat e propozuara si në aktakuzë, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në këtë çështje penale pa asnjë dyshim e përtej dyshimit të bazuar mirë u vërtetua që i akuzuari K.H e ka kryer veprën penale nga neni 269 par.2 i KPRK-se. Kjo u vërtetua fillimisht me dëgjimin e dëshmitarëve- zyrtarëve policor B.O, J.SH dhe D.B, të cilët para gjykatës janë deklaruar lidhur me rrethanat në të cilat ka ndodhur rasti.

Poashtu me dëgjimin e dëshmitarit D.Z është vërtetuar që në ditën kritike kur zyrtarët policor janë paraqitur tek vendi ku ka ndodhur rasti, i njëjti e ka parë të pandehurin qe e ka shkelur cigaren, e cila cigare pastaj ka rezultuar që ka qenë e përzier me substance narkotike. Dëshmitari pasi që e ka deklaruar këtë fakt në shqyrtim gjyqësor, me rastin e marrjes në pyetje nga ana e të pandehurit ka deklaruar se distanca në mes këtyre të dyve dhe cigares së gjetur në tokë ka qenë 7m , ndërsa paraprakisht në pyetjet e PSH i njëjti deklaroi se po e kam parë që e ka shkel cigaren me këmbë, andaj gjykatës i kërkoi që me rastin e vlerësimit të dëshmisë së tij të njëjtës t'ia fal besimin pjesërisht dhe atë lidhur me faktin se i njëjti fillimisht deklaroi se e ka parë duke shkelur cigaren ndërsa në anën tjetër thotë se distanca ka qenë 7m, çka logjikisht një fakt i tillë nuk mund të ndodh.

Sot edhe vet i pandehuri në deklarimin e tij respektivisht gjatë dhënies së mbrojtjes, deklaroi se apo thënë më mirë e pranoi që substancën e dyshuar narkotike e ka pasur ne posedim por qe sipas tij ajo ishte dhënë nga ana e zyrtarëve policor me qëllim që ky-pra i pandehuri të bën verifikimin e llojit të substancës.

Pra, i njëjti meqenëse e pranon qe substancën e ka pasur ne posedim por duke shtuar një arsye të tillë, e vërteton aktakuzën e Prokurorisë së Shtetit, po ashtu gjykatës i kërkoi që me rastin e vlerësimit të mbrojtjes së tij të mos i falet besimi arsyesimit të tij për shkak se i njëjti paraprakisht kur u pyet nga ana e Prokurorit të Shtetit se gjate kohës kur ka dhënë deklaratë në polici a ka pasur dhunë fizike apo psikike nga ana e zyrtarëve policor, u deklarua se jo, se deklarata e ka dhënë me vullnet të plotë si dhe tha që zyrtarët policor të cilët i kemi dëgjuar si dëshmitar, nuk i njeh, nuk ka pasur mosmarrëveshje me ta duke shtuar se zyrtari policor i'a ka hedhur substancën para këmbëve, dhe atë duke i'u referuar cigares që ka pasur në përmbajtje substancë narkotike. I njëjti në polici ka deklaruar se në ditën kritike ka pirë cigare të llojit Ëinston ndërsa sot gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë tha se ka pirë cigare Marlboro të kuqe, pra të gjitha këto fakte të deklaruara nga vet i pandehuri si dhe të dëshmuara edhe nga vet dëshmitarët e tjerë pa asnjë mëdyshje e vërtetojnë fajësinë e të pandehurit, andaj gjykatës i kërkoi që i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet për veprën që i vihet në barrë duke marr parasysh si rrethanë rënduese rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e kësaj vepre penale e cila vërtetohet nga vet përshkrimi gjendjes faktike si në dispozitiv të aktakuzës, ndërkaq si rrethanë lehtësues i propozojmë gjykatës të mos marr asnjë te tillë sepse ne rastin konkret nuk gjejmë asnjë rrethanë të vetme lehtësuese.

I pandehuri ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e ndien veten fajtor, se substanca nuk ka qene e tij dhe pretendimet e Prokurorisë janë të paqëndrueshme.

#### *Provat e administruara*

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë shqyrtuar provat si në vijim:

Lexohet raporti i oficerit i datës 24.03.2022; Raporti i ekspertimit i datës 09.03.2023; Raporti policor i datës 24.03.2022 hartuar nga polici hetues; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin D.Z i datës 10.03.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje te pandehurit K.H i datës

24.03.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 24.03.2022; Foto dokumentacioni, foto nr.1,2,3,4, ku shihet substanca e dyshuar narkotike e vendosur në peshore.

Në cilësinë e dëshmitarit nga ana e prokurorisë është propozuar dëshmitari B.O, zyrtar policor, i cili ka deklaruar se me datën 24.03.2022, rreth orës 18:30 ka qenë në detyrë zyrtare me rroba civile dhe atë ditë kanë qenë të ngarkuar me planin X-ray, për personat që posedojnë dhe shpërndajnë substanca narkotike. Tutje ka shtuar se në ditën kritike kanë qenë në lokacion të Stadiumi i gomës, i cili njihet si vend që frekuentohet nga persona që përdorin substanca narkotike dhe po këtu në distancë prej 8-10 metra i kemi parë personat K.H dhe D.Z, ndërsa nuk kemi hasur në persona tjerë, duke shtuar se të njëjtit i kanë legjitimuar, ndërsa në momentin që i kanë takuar, të njëjtit kanë bërë lëvizje të çuditshme. Tutje ka shtuar se afër të pandehurit, në distancë prej 1 ose 1.5 metra kanë gjetur substancë narkotike, pika për sy dhe një cigare të ndarë në gjysme, ndërsa ka shtuar se nuk i kujtohet nëse e ka parë të pandehurin duke hedhur substancën narkotike dhe as nëse e ka shkelur gjysmën e cigares, por ka theksuar se qëndron prapa raportit policor të përpiluar.

Në cilësinë e dëshmitarit nga ana e prokurorisë është propozuar dëshmitari J.SH, zyrtar policor i cili ka deklaruar se me datën 24.03.2022, rreth orës 18:30 ka qenë në detyrë zyrtare dhe atë ditë kanë qenë të ngarkuar me planin X-ray, për personat që posedojnë dhe shpërndajnë substanca narkotike. Tutje ka shtuar se në ditën kritike kanë qenë në lokacion të Stadiumi i gomës, i cili njihet si vend që frekuentohet nga persona që përdorin substanca narkotike. Tutje ka shtuar se në atë vend, në atë kohë nuk ka parë persona tjerë përpos të pandehurit K.H dhe D.Z, dhe se substanca narkotike është gjetur afër të pandehurit, në distancë jo më të madhe se 1 metër dhe se përveç substancës narkotike, kanë gjetur edhe një pako me cigare, pika për sy dhe një cigare të ndarë në gjysmë por që nuk i kujtohet nëse e njëjta ka qenë e të pandehurit dhe nëse i pandehuri ka pasur sytë e skuqur. Po ashtu, i njëjti ka deklaruar se nuk i kujtohet nëse e ka parë të pandehurin duke e hedhur substancën narkotike, nuk i kujtohet sa ka qenë distanca në mes tyre dhe të pandehurit kur e ka parë të njëjtin, ndërsa nga momenti kur e kanë parë të pandehurin deri te arritje te vendi ku ishte i pandehuri kanë kaluar 30 sekonda, ndërsa nuk i kujtohet nëse kanë gjetur letra që shërbejnë për mbështjelljen e cigareve.

Në cilësinë e dëshmitarit nga ana e prokurorisë është propozuar dëshmitari D.B, zyrtar policor i cili ka deklaruar se në policinë e Kosovës është në Njësinë e Ndërhyrjes së Shpejt nga shkurti i vitit 2023, ndërsa në Mars të vitit 2022 ka qenë policë në patrullë, me rroba civile duke zbatuar planin operativ X Ray me qëllim të parandalimit të dukurive negative – narkotikëve. I njëjti ka deklaruar se rasti saktësisht nuk i kujtohet, Po ashtu nuk i kujtohet nëse e ka parë të pandehurin në ditën kritike por ka shtuar që qëndron në tërësi prapa raportit të përpiluar për rastin.

I pandehuri, në seancën e datës 10.07.2024 ka zgjedhur që të deklarohet për çështjen penale, dhe i njëjti deklaroi se në ditën kritike në orën e njëjtë ka qenë te stadiumi i gomës në Vushtrri me shokun e tij D.Z, dhe janë ulur për ta pira nga një cigare Marlboro të kuqe unë ndërsa D.Z e ka pasur Winston. Ka ardhur një veturë - xhip Toyota e policisë për të na kontrolluar dhe kanë qenë më rroba civile, unë jam ngritur në këmbë për të shikuar se kush është, pasi që ata na janë afruar me veturë diku rreth 10m, në më pas e kuptuam që janë policia dhe unë u ula, i nxjerra duart nga

xhepa, të njëjtit na legjitimuan - na kërkuan dokumentet personale, më pas na kanë verifikuar, na kanë kontrolluar, dy polici kanë qëndruar afër në distancë 1m, ndërsa një polic tjetër ka kontrolluar përreth neve. Diku 7-8m larg nesh një polic e ka gjetur një qese me marihuanë të cilën e kam prekur unë për ta shikuar se a është e njomë, pasi polici me ka pyetur se a është kjo substancë e jotja e unë i kam thënë jo dhe poashtu një cigare e kam prek të cilën ma ka dhënë polici dhe ka qenë e tharë, dhe unë i kam thënë “ kjo cigare qenka qe 100 vjet”, dhe e ka vendosur polici para këmbëve te mija, dhe kur të njëjtit na kane urdhëruar që të hipim në veture unë e kam shkelur cigaren e cila ka shërbyer si provë, dhe këtë e kam bërë pa qellim, nuk e kam parë. Policia kur më kanë kontrolluar më kanë gjetur cigare, telefonin dhe pika për sy te cilat janë për mjekim të syrit dhe quhen Procolin. Në të kaluarën unë kam qenë përdorues por që 3 vite nuk konsumoj më. Tutje ka shtuar se me datën 24.03.2022 ka dhënë deklaratë në polici, të cilin e ka dhënë me vullnet të plot, pa presion dhe pa dhunë ndërsa me rastin e prezantimit të procesverbalit i njëjti ka deklaruar se është nënshkrimi i tij. Tutje ka shtuar se policia ka ardhur pak para se të errësohet, ku të njëjtit kanë qenë ulur, ndërsa i pandehuri me të parë se po vjen dikush është ngritur në këmbë për shikuar duke menduar se janë shokët e tij.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet, vlerësimi i provave*

Është fakt jokontestues se i pandehuri në ditën kritike, së bashku me shokun e tij – dëshmitarin D.Z kanë qenë në stadiumin e gomës në Vushtri.

Është fakt jokontestues se të njëjtit janë hasur nga policia, janë legjitimuar, dhe se afër tyre është gjetur substancë narkotike e llojit marihuanë.

Këto fakte jokontestuese janë pohuar nga vetë palët.

Për gjykatën kontestuese ishte nëse substanca narkotike e llojit marihuanë e gjetur në afërsi të të pandehurit ishte e tij.

I pandehuri lidhur me veprën penale për të cilën ngarkohet nuk e ka pranuar fajësinë.

Nga raporti i oficerit, i datës 24.03.2022 gjykata ka vërtetuar se me datën 24.03.2022, rreth orës 18:35 patrulla policore në zbatim të planit operativ X Ray duke hasur në dy persona dhe atë në K.H – të pandehurin dhe D.Z ku gjatë kontrollit, në afërsi prej 1 metri gjejnë një qese të vogël e cila dyshohej se ishte substancë narkotike, ndërsa tek këmbët e tyre një cigare të ndarë në gjysmë e cila dyshohej se është përzier me substanca narkotike.

Nga raporti i ekspertimit i datës 09.03.2023 i përpiluar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka vërtetuar faktin se:

- Dëshmia #1 e cila ishte qese plastike e tejdukshme që ka të ngjitur letër të bardhë me mbishkrimin “2022-BD-0248; D#1;...” që përmban substancë bimore me ngjyrë të gjelbër, me peshë neto 0.37 gram, pas analizimit të së njëjtës ka rezultuar se dëshmia #1 përmban Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto 0.37gram;

- Dëshmia #2 e cila ishte qese plastike e tejdukshme që përmban një letër me ngjyrë të bardhë më mbishkrimin “2022-BD-0248; D#2;...” dhe një gjysmë cigare me ngjyrë të bardhë/kafe, me mbishkrimin “Winston” që përmban substancë bimore me ngjyrë kafe, peshë neto 0.17 gram, pas analizimit, ka rezultuar se nuk përmbajnë asnjë narkotik të rrezikshme, substancë psikotrope apo prekursorë, me peshë neto 0.17gram.

Nga procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin D.Z, i datës 10.03.2022 gjykata ka konstatuar se i njëjti ka dhënë deklaratë në polici ku ndër të tjera ka deklaruar se qesja e gjetur e dyshuar për substancë narkotike nuk është tij, nuk e din nëse ka qenë e shokut të tij. Tutje ka shtuar se i njëjti nuk konsumon substanca narkotike edhe pse më parë ka konsumuar, dhe as nuk e din nëse shoku i tij konsumon. Poashtu ka shtuar se cigarja e ndarë në gjysmë Ëinston gjetur në tokë nuk është e asnjërit prej tyre, edhe pse i njëjti e konsumon qe 7 vite atë lloj cigare dhe gjetja e saj në tokë ishte rastësi. Në fund ka shtuar se shoku i tij – K.H – i pandehuri atë cigare e ka shkelur gabimisht.

Nga procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin K.H, i datës 24.03.2022, gjykata ka konstatuar se i njëjti ka dhënë deklaratë në polici, ku ndër të tjera ka deklaruar se se para hyrjes së parku është takuar me shokun e tij D.Zn, dhe prej aty kanë shkuar të Stadiumi i gomës, ku janë ulë dhe kanë pirë nga një cigare dhe me atë rast kanë ardhur policia dhe na kanë kontrolluar, ku mua mi kanë gjetur dokumentet, telefonin, pika për sy procolin dhe asgjë tjetër. Tutje ka deklaruar se i njëjti e konsumon kohë pas kohe marihuanën. Lidhur me qesen e gjetur afër vendit ku kanë qenë ulur, i njëjti ka deklaruar se e njëjta nuk ka qenë as e tij e as e D.Zt dhe se e njëjta ka qenë afërsisht 6-7 larg nga vendi ku këta kanë qenë ulur.

Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i datës 24.03.2022, gjykata ka vërtetuar se nga i pandehuri janë është konfiskuar substancë të dyshuar për narkotik dhe një cigare të dëmtuar Winston.

Nga foto dokumentacioni, shihet substanca e dyshuar për narkotik cigarja e dëmtuar, të konfiskuara nga i pandehuri.

Gjykata u ‘a ka falur në tërësi besimin dëshmisë së dëshmitarëve – zyrtarëve policor B.O, J.SH, D.B, pasi që deklaratat e dhëna nga të njëjti ishin konsistente, nuk ishin kundërthënëse dhe ishin në përputhje të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe raportin e oficerit dhe atë policor të përpiluar për rastin.

Dëshmisë së dëshmitarit D.Z, gjykata i ‘a fali besimin vetëm pjesërisht dhe atë vetëm sa i përket faktit se i njëjti ka qenë ditën kritike me të pandehurin, pohimit të tij se është gjetur një këse e substancës narkotike, ndërsa në pjesët tjera deklarimi i tij në shqyrtim gjyqësor ishte kundërthënëse dhe nuk ishte në përputhje me provat e tjera në shkresat e lëndës. Për më tepër, gjatë marrjes në pyetje në polici ka deklaruar se rasti ka ndodhur rreth orës 17:35, ndërsa gjatë deklarimit në gjykatë ka deklaruar se rasti ka ndodhur rreth orës 18:00 ose 19:00.

Dëshmisë së të pandehurit K.H, gjykata nuk i'a fali besimin e plotë pasi që e njëjta ishte kundërthënëse, nuk ishte në përputhje me provat e tjera në shkresat e lëndës. I njëjti me rastin e deklarimit në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se qesen me marihuanë dhe cigaren e ka prekur pasi që policia i'a kanë ofruar për prekje, ndërsa në deklaratën e dhënë në polici i njëjti asnjëherë nuk ka deklaruar se policia i'a ka ofruar të njëjtat për t'i prekur, me qëllim që ky i fundit të shikoj nëse është e njomë. Për gjykatën arsyetimi i të njëjtit nuk është i qëndrueshëm ,pasi që identifikimi i një substancë bëhet nga Agjencia përkatëse me metoda dhe mjete shkencore dhe jo me prekje e aq më pak një veprim i tillë të ndodhë nga zyrtar policor.

Tutje i pandehuri ka deklaruar se edhe gjatë marrjes në pyetje në polici ka deklaruar se policia i'a kanë ofruar për prekje substancën narkotike, por që në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se deklaratën e dhënë në polici e ka bërë me vullnet të plot, pa presion pa dhunë, se zyrtarët policor nuk i njeh, nuk ka pasur asnjëherë mosmarrëveshje me të njëjtit.

Po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga provat në shkresat e lëndës dhe dëshmia e dëshmitarëve por edhe e vet të pandehurit u vërtetuar së vendin ku është hasur i njëjti me shokun e tij D.Zn, pra ku është gjetur edhe qesja me substanca narkotike, nuk ka pasur asnjë person tjetër, pra kanë qenë vetëm këta të dy, e ky fakt të dërgon te pamundësi që qesen me substancë narkotike të ketë qenë e dikujt tjetër dhe që ajo qese apo që i pandehuri me shokun e tij D.Zn që qëllonjë rastësisht afër saj.

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, vepra penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 kryhet nga *“Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.”* ndërsa me paragrafin 2 është parashikuar se *“Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.”*

Sipas vlerësimit të gjykatës, përmes provave të administruara dhe dëshmitarëve të pyetur është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë. Pra, gjykata gjatë procedimit gjyqësor ka vërtetuar se i pandehuri ka pasur në posedim substancave narkotike, dhe atë marihuanë me përmbajtje Tetrahidrokanabinol (THC) me peshe neto 0.37 gram, e cila përmbajtje është vërtetuar nga ekspertimi nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë.

I pandehuri përveç që ka mohuar kryerjen e veprës penale, i njëjti nuk ka prezantuar asnjë provë dhe asnjë dëshmitar me të cilat/cilët do të mund të argumentonte para gjykatës të kundërtën e pretendimeve të prokurorisë në aktin akuzues.

*Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit me gjobë gjykata morri parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, meqë rast vepra është kryer me dashje të lartë nga ana e të pandehurit. Si rrethanë tjetër rënduese gjykata ka marr edhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës

së kryer nga i pandehuri, sidomos duke pasur parasysh se e njëjta është kryer në qendër të qytetit dhe atë në fushë të sportit.

Gjykata, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë për bazë faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar për vepra penale si dhe moshën e re në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe të ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Arsyet lidhur me konfiskimin, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Urdhërin për konfiskimin e substancës narkotike gjykata e ka marrë konform nenit 269 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se “Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen.”

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË V...

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.195/23, datë 08.08.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.